



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, po ashtu duke u bazuar në nenin 25, paragrafi 6, pika 1, të këtij Ligji, Bordi Mbikëqyrës i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	01
NR PROT BR PROT NR PROT.	400
NUMRI I FASEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	11
DD.MM.VVVV DD.MM.GGGG DD.MM.YYYY:	22/03/2017
PRISHTINË / A	

**RREGULLORE Nr. 02/2017 PËR RAPORTIMIN E MONITORIMIT TE TREGUT  
HEKURUDHOR**

Prishtinë, 2017

Rr. Rustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

Neni 1  
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton përmbajtjen dhe raportimin e të dhënave për zhvillim në sektorin e hekurudhave të cilat të dhëna mblidhen nga Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor në kuadër të funksionit të tij monitorues të sektorit hekurudhor.

Neni 2  
Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj rregullore do të përdoren përkufizimet nga Neni 3 i Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Neni 3  
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen tek të gjitha palët e interesit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me monitorimin e rregullimit të tregut, nga Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-së

Neni 4  
Palët e Interesit

1. **ARH** – Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave si organi me i lart i cili është përgjegjës i mbikëqyrje së sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës.
2. **Menaxherët e Infrastrukturës** – ndërmarrjet publike që merren me menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore në vend.
3. **Ndërmarrjet Hekurudhore** – operatorët e licencuar për shërbimet e transportit hekurudhor
4. **Ministria** – Ministria përkatëse përgjegjëse për sektorin e transportit.
5. **Ministria përgjegjëse për Ndërmarrjet Publike**- Ministria përkatëse që monitoron dhe mbikëqyrë (pronare) ndërmarrjet publike në Kosovë

Neni 5  
Organi Përgjegjës i Monitorimit

1. Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave është Organ Përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e tregut hekurudhor në Republikën e Kosovës.
2. Raporti vjetor i monitorimit të tregut hekurudhor do të inkorporohet në raportin vjetor të Departamentit për Rregullimin e Tregut.

